



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

---

# Buletini informativ

- **Aktivitetet e përgjithshme**
- \* **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- \* **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- \* **Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial**
- \* **Aktivitetet për profesionistët tjerë ligjor**
- \* **Trajnimi i Trajnuesve**

**Maj 2022**

## Aktivitetet e përgjithshme

### Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi

Më 10 maj 2022, Akademia e Drejtësisë dhe Agjencia për Informim dhe Privatësi kanë



nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Marrëveshja e Bashkëpunimit, e nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv i AD-së, z.Enver Fejzullahu

dhe Komisionerja për Informim dhe Privatësi, znj. Krenare Sogojeva- Dermaku, ka për qëllim bashkërendimin e aktiviteteve të dy institucioneve në sferën e avancimit të çështjeve me interes reciprok, me theks të veçantë afirmimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike.

Me këtë rast, z.Fejzullahu dhe znj. Sogojeva-Dermaku u zotuan se të dyja palët do të koordinojnë së bashku aktivitetet me interes të përbashkët, të cilat do të zbatohen në mirëkuptim reciprok dhe në përputhje me rregulloret dhe politikat e të dyja institucioneve respektive.



## Program Ndërkombëtar i Trajnimit për çështjet bashkëkohore në fushën e të drejtave të njeriut

Me 23-26 maj 2022 Akademia e Drejtësisë së Turqisë dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) në Antalya të Turqisë ka realizuar aktivitetin me temë “Programi Ndërkombëtar i Trajnimit për çështjet bashkëkohore në fushën e të drejtave të njeriut”.



Në këtë aktivitet morën pjesë shtetet nga Ballkani Perëndimorë si: Kosova, Shqipëria, Bosnje-Hercegovina dhe Republika Srpska, Bullgaria, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Rumania. Turqia ishte nikoqire e këtij aktiviteti.

Kosova u përfaqësua nga tre gjyqtarë të gjeneratës së tetë në programin e trajnimit fillestar znj. Verona Dibra, z. Arnis Dumani dhe z. Gent Bekeri si dhe nga stafi i Akdemisë së Drejtësisë Drejtori Ekzekutiv z. Enver Fejzullahu si dhe znj. Valmira Pefqeli, Udhëheqëse e Trajnimit

Fillestar.

Në këtë program trajnimi u trajtuan dhe u analizuan zhvillimet më të fundit në fushën e të drejtave të njeriut dhe jurisprudenca e GJEDNJ. Sipas programit në ditën e fundit të aktivitetit ekipet përfaqësuese të shkollave gjyqësore morën pjesë në konkursin mbi jurisprudencën e GJEDNJ. Nga prezantime që bënë ekipet pjesëmarrëse, Shkolla e Magjistraturës së Maqedonisë së Veriut u shpall fituese ndërsa për prezantimin individual u shpall fituese znj. Olta Cenaj nga Shkolla e Magjistraturës së Shqipërisë.

Në përfundim të programit Presidenti i Akademisë së Drejtësisë së Turqisë, z. Muhittin Özdemir bashkë me drejtuesin e departamentit për marrëdhënie me jashtë z. Hasan Kadir Yilmaztekin zhvilluan një takim me Drejtorin e Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu. Në takim u diskutua mundësia e nënshkrimit të një memorandumi bashkëpunimi dypalësh, me qëllim të bashkërendimit të aktiviteteve të përbashkëta që i kontribuojnë ngritjes së kapaciteteve dhe shkëmbimit të përvojave në mes dy shteteve.



## Nënshkrim i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe Organizatave Joqeveritare

Me datë 31 Maj 2022, Akademia e Drejtësisë me mbështetje të Projektit të BE-së EU-KOJUST nënshkroi Memorandum të Bash-



këpunimit me Organizatat Joqeveritare si BIRN

dhe Internews Kosova, KDI, KLI, ATRC, KGSC, VoRAE, CEL, CSGD.

Përmes këtij Memorandumi synohet përdorimi i përvojës dhe kapaciteteve të të gjitha palëve në promovimin e praktikave më të mira për gjyqtarët, prokurorët dhe stafin mbështetës.

Kjo punëtori u përcjell me diskutime të aspektit teknik për metodologjinë dhe praktikat më të mira të trajnimit gjyqësor.



## **Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare**

Gjatë muajit maj aktivitetet e këtij programi kanë qenë të orientuara në përgatitjet paraprake për programin trajnues për gjeneratën e IX të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj të cilët pritet së shpejti të dekretohen pasi janë përfunduar gjitha fazat e rekrutimit nga KGJK dhe KPK.

Në kuadër të këtyre përgatitjeve ka filluar hartimi i moduleve trajnuese dhe përditësimi i tyre përshtatshëmrisht me legjislacionin aktual në fuqi.

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Trajnimi: Roli dhe zbatimit i Ligjit për Azilin si dhe raporti i tij me Konventen ndërkombëtare për azilin

---

Me 04 maj 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: Roli dhe zbatimi i Ligjit për azilin si dhe raporti i tij me Konventën ndërkombëtare për azilin.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët të njihen më për së afërmi me Ligjin për Azilin, sidomos nga këndvështrimet e raportit të tij ndaj Konventave Ndërkombëtare, protokolleve përkatëse dhe zbatimin e tyre në praktikë me rastin e vendosjes për të drejtën e azilit.

Trajnimi u fokusua në elaborimin e dispozitave ligjore në fuqi, qoftë kornizës ligjore vendore ashtu edhe asaj ndërkombëtare. Vëmendje e veçantë i është kushtuar dispozitave që kanë të bëjnë me procedurën lidhur me kërkesën e azilkërkuësve të ushtruar pranë Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim në kuadër të Min-

istrisë së Punëve të Brendshme dhe Komisionit Kombëtar për Refugjatë të Kosovës si dhe dispozitave që kanë të bëjnë për inicimin e Konfliktit Administrativ dhe procedurat pranë gjykatës kompetente.

Trajnimi kryesisht u zhvillua në formë të bashkëbisedimit mes pjesëmarrësve dhe trajnuesit dhe me përdorimin e rasteve studimore nga praktika gjyqësore në vend, rajon dhe Evropë. Me këtë rast u shkëmbyen përvojat dhe dilemat duke ofruar praktikat më të mira në këtë fushë.

Përfitues në këtë trajnim ishin 2 gjyqtarë të nivelit themelor si dhe 2 zyrtarë të lartë për azil nga Ministria e Punëve të brendshme, respektivisht nga Departamenti për Shërbime të Azilit dhe Migrimit.



## Program i specializuar i trajnimit-Pastrimi i parave dhe hetimi financiar-Sesioni II

Me 04 - 05 Maj 2022, në bashkëpunim me GIZ, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar Programi i Specializuar i Trajnimit-Pastrimi i parave dhe hetimi financiar - Sesioni II

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me Hetimin dhe sigurimin e provave në rastet e pastrimit të parave, teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave si dhe përgatitja e profilit personal.

Në ditën e parë trajnimi kryesisht u zhvillua në formë të bashkëbisedimit mes pjesëmarrësve dhe trajnuesit lidhur me përvojat, dilemat dhe çështjet procedurale në rastet hetimit dhe sigurimit të provave, pastaj për teknikat e ekzaminimit të mashtrimeve tek pastrimi i parave, për mbledhjen e informatave dhe për përgatitjen e profilit personal.

Në ditën e dytë trajnimi u fokusua në sqarimet sa i përket procesit të gjurmimit të fondeve si nga ana e marrësit ashtu edhe nga ana e paguesit si dhe të rikthimit të pasurive të fshehura.

Pjesëmarrësit patën mundësinë që përmes rastit praktik të adresojnë dilemat praktike dhe të njohin praktikat më të mira gjyqësore nën rastet përkatëse.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 6 gjyqtarë të nivelit themelor ( 1 nga Departamenti special, 1 nga departamenti për krime të rënda dhe 4 të tjerë nga departamenti i përgjithshëm) si dhe 5 prokuror ( 1 nga Prokuroria Speciale, 1 nga Prokuroria e Apelit si dhe 3 të tjerë nga Prokuroria Themelore)



## Program i specializuar i trajnimit-Mashtrimi dhe Korrupsioni në Prokurimin Publik-Sesioni I

---

Me 10-11 maj 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar Programi i Trajnimit të Specializuar me temë: “Mashtrimi dhe Korrupsioni në Prokurimin Publik-Sesioni I”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zhvillimi i shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në identifikimin e indikatorëve serioz të mashtrimit gjatë fazave të prokurimit publik dhe skemat e korrupsionit në këtë fushë për zgjedhjen e rasteve gjyqësore në praktikë në mënyrë meritore.

Në ditë e parë trajnimi i fokusua në trajtimin e parimeve të përgjithshme të Ligjit të Prokurimit Publik, kornizës institucionale në fushën e prokurimit, funksionet dhe përgjegjësitë e akterëve kryesor në procedurat e prokurimit publik, rolin dhe përgjegjësitë e Organit Shqyrtues të Prokurimit si dhe përkufizimet sa i përket korrupsionit dhe mashtrimit në procesin e prokurimit duke ofruar mundësinë e diskutimit interaktiv edhe me pjesëmarrësit.

Në diën e dytë vëmendje e veçantë i është

kushtuar rasteve të mashtrimit dhe korrupsionit në fazën para tenderimit, përkatësisht skemat tipike të mashtrimit në prokurim, pastaj në fazën e tenderimi si dhe në fazën pas dhënies së kontratës.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe ofrimit të metodave efektive në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe mashtrimit në prokurim publik, se si të bëhet identifikimi i indikatorëve serioz të mashtrimit gjatë fazave të prokurimit publik dhe mënyrat dhe cilat janë skemat e korrupsionit në fushën e prokurimit publik.

Gjatë trajnimit është përdorur metoda interaktive, ku ka patur diskutime dhe pyetje nga pjesëmarrësit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 11 gjyqtarë (9 gjyqtarë të nivelit themelor, 1 nga Apeli dhe 1 nga Gjykata Supreme), 6 prokuror nga niveli themelor dhe 5 ekspert nga Prokuroria Speciale si dhe 5 zyrtarë policor dhe hetues nga Policia e Kosovës.





## Trajnimi: Prishja e Rendit dhe Qetësisë Publike

---

Më 12 Maj 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Prishja e Rendit dhe Qetësinë Publike”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zhvillimi i shkathtësive të gjyqtarëve në identifikimin dhe dallimet mes dispozitave të nenit 4 dhe 5 të Ligjit për rendin dhe qetësisë publike si dhe nenit 16 të këtij ligji me Ligjin për kundërvajtjet për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve në procedurë gjyqësore.

Trajnimi u fokusua në interpretimet dhe sqarimet sa i përket dispozitave të nenit 4 dhe 5 të Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike si dhe në dallimin në mes mosrespektimit të urdhrimit të personit të autorizuar zyrtar - neni 16 LRQP dhe kundërvajtjes – mosveprim sipas urdhrimit të personit të autorizuar zyrtar nga lëmi i trafikut rrugor. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe sanksioneve të parapara për kryesit e kundërvajtjeve dhe prishësve të rendit dhe qetësisë publike, përkatësisht ndëshkimet

për shkeljen e dispozitave përkatëse.

Me rastin e këtij trajnimi u theksua se legjislacioni në fuqi për rendin dhe qetësinë publike është mjaftë i varfër dhe i mangët në përfshirjen dhe përkufizimin e kundërvajtjeve dhe si i tillë në shumë raste paraqet problem në zbatim. Në vazhdim u adresuan problemet praktike veçanërisht kur kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse bëhet nga organi jo kompetent apo edhe nga organi i pa autorizuar, prandaj edhe u sugjerua që në këto raste kërkesa duhet të hedhet poshtë me aktvendim. Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 15 gjyqtarë, prej tyre 1 nga Gjykata e Apelit dhe 14 të tjerë nga Gjykatat Themelore nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Trajnim: Rikuperimi i pasurive të vjedhura

Me 16 - 20 Maj 2022, në bashkëpunim me UNDP, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “Rikuperimi i pasurive të vjedhura”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me Hetimet financiare dhe rikuperimin e aseteve për hetimin dhe gjykimin e rasteve të pastrimit të parave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Trajnimi për pesë ditë me radhë ka trajtuar aspekte të rëndësishme të pastrimit të parave, gjurmimit të aseteve, organizimit të provave elektronike duke i demonstruar këto edhe përmes ushtrimit praktik të gjurmimit të aseteve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar elementeve të krimit, sfidave në hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave dhe rikuperimit të aseteve në Kosovë, qasjeve për hetimet financiare dhe metodave indirekte për vër-

tetim të të hyrave ilegale. Gjithashtu janë trajtuar edhe aspekte të rëndësishme të ndihmës së ndërsjellë juridike dhe mekanizmat për konfiskim të aseteve.

Pjesëmarrësit patën mundësinë që përmes ushtrimeve praktike të adresojnë dilemat praktike, shkëmbejnë përvojat dhe të njohin praktikat më të mira gjyqësore në rastet përkatëse.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 7 gjyqtarë të nivelit themelor (1 nga Departamenti special, 2 nga Departamenti për krime të rënda dhe 4 të tjerë nga Departamenti i përgjithshëm), 4 prokuror (1 nga Prokuroria Speciale, 1 dhe 3 të tjerë nga Prokuroria Themelore), 8 zyrtarë policor, 2 nga Njësia për intelgjencë financiare si dhe 1 staf administrativ nga prokuroria.



## Trajnimi: Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave Personale dhe mbrojtja administrative dhe gjyqësore e të drejtave personale dhe procedurën e realizimit të drejtave për qasje në informata

Më 17 Maj 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe mbrojtja administrative dhe gjyqësore e të drejtave personale si dhe Ligji për qasje publike dhe procedurën e realizimit të drejtave për qasje në informata”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zhvillimi i shkathtësive të gjyqtarëve për mbrojtjen gjyqësore të së drejtës së privatësisë në rastet konkrete në praktikën gjyqësore në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe ligjore.

Në pjesën e parë trajnimi u fokusua në kornizën ligjore në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, mbrojtjen e të dhënave në kontekst të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe të KEDNJ-së, parimet e përpunimit të të dhënave personale, legjitimitetin e përpunimit të të dhënave personale, të dhënat personale të ndjeshme, ndarja dhe kriteret për përpunimin e tyre, të drejtat e subjekteve dhe obligimi i kontrolluesve, siguria e të dhënave personale, konceptet themelore dhe në fund këshilla dhe rekomandime për sigurinë e të dhënave personale.

Mbrojtja administrative e të dhënave personale,  
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave personale;

Procedura e realizimit të të drejtave për qasje në informata, Pagesat për qasje në dokumente zyrtare, Përrjashtimet e së drejtës së qasjes në dokumente publike,

Në pjesën e dytë është diskutuar për transmetimin e informacioneve themelore të ndjekësit, lidhur me të drejtën e qytetarëve për t’u qasur në dokumente publike, të prodhuara, mbajtura apo pranuar nga institucionet publike, si dhe shpalosja e përgjegjësisë ligjore të zyrtarëve përgjegjës me kompetenca vendimmarrëse brenda këtyre institucioneve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar rasteve kur bëhet kërkesa për qasje në dokumente publike, shqyrtimi i saj, afatet për shqyrtim, bazat e lejueshme për refuzim dhe qasja e lejuar në çdo rrethanë si dhe aspekte tjera me rëndësi sa i përket ankesave dhe vendimmarrjes së Agjencisë.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 14 gjyqtarë kryesisht nga departamenti i administrativ dhe i përgjithshëm të nivelit themelor.



## Program i Specializuar i trajnimit-Krimi Kibernetik dhe kriptovalutat

Më 18-19-20 Maj 2022, në kuadër të trajnime të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit - Krimi Kibernetik dhe kriptovalutat – Sesiioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët dhe prokurorët të njoftohen për së afërmi me Krimin kibernetik si vepër penale në legjislacionin e brendshëm, procedurën dhe praktikën në lidhje me provat elektronike për zgjidhjen e drejtë dhe meritore të rasteve gjyqësore.

Fokus të theksuar në këtë trajnim ishin sfidat që hasin prokurorët dhe gjyqtarët gjatë trajtimit të rasteve të krimit kibernetik, zbatimit të dispozitave materiale në përgjithësi, e në veçanti vepra penale: pornografia me fëmijë, gjegjësisht të gjitha format e kryerjes së kësaj veprë por edhe veprat penale të shfrytëzimit seksual ku subjekt janë fëmijët (ndjeshmëria dhe rëndësia e tyre), bashkëpunimi me ofruesit e shërbimeve, ruajtja e përsheptuar e të dhënave të rastet urgjente, si dhe parashtrimi i kërkesave për ndihmë juridike-ndërkombëtare. Gjyqtarët dhe prokurorët janë njoftuar me Ligjet e veçanta që rregullojnë këtë materie, në veçanti edhe me dispozitat e Ligjit për

Komunikime elektronike, që kanë të bëjnë me kompetencat dhe detyrimin e ofruesve të shërbimeve për të bashkëpunuar me zbatuesit e ligjit, për të zbatuar urdhërat e prokurorisë dhe gjykatës, për afatet e përcaktuara kohore të përcaktuara në këtë Ligj dhe mënyrën e bashkëpunimit ndërinstitucional. Gjithashtu u fol edhe për kriptovalutat si temë shumë e spikatur dhe e diskutueshme edhe në mesin e profesionistëve të sektorit privat dhe publik që janë të përfshirë në parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave. Në vijim u theksua se kriptovaluta më e mirënjohur Bitcoin, ka ngjallur shumë interesim posaçërisht për faktin se mediat vazhdojnë të merren me një numër të hetimeve dhe të ndjekjeve me profil të lartë në tërë botën.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 7 gjyqtarë ( 1 nga Gjykata e Apelit dhe 6 nga niveli themelor) dhe 7 prokuror ( 1 nga Apeli dhe 6 nga niveli themelor)



## Tryezë: Liria e Shprehjes dhe mediave-Regjioni Prishtinë

Me 19-20 maj 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme dhe në mbështetje të Këshillit të Evropës, përkatësisht projektit JUFREX është realizuar tryeza për Lirinë e shprehjes, shpifja dhe mbrojtja e reputacionit dhe siguria e gazetarëve.

Qëllimi i kësaj tryeze është zhvillimi i shkathtësive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në mbrojtjen gjyqësore në rastet e shkeljes së të drejtave të qytetarëve dhe në veçanti liria e shprehjes dhe në rastet e shpifjes.

Tryeza për dy ditë me radhë ka trajtuar konceptet themelore të lirisë së shprehjes dhe medias, shpifjen dhe mbrojtjen e reputacionit bazuar në standardet e GJEDNJ-së, pastaj mekanizmat tjerë për mbrojtje me fokus te roli i Komisionit të Pavarur për Media dhe Këshillit të Mediave të shkruara, për sigurinë e

gazetarëve të cilat janë shoqëruar me raste nga praktika gjyqësore vendore dhe ajo e GJEDNJ-së. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe zhvillimeve të fundit të Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjatë tryezës janë përdorur metoda interaktive, ku ka patur diskutime dhe pyetje nga pjesëmarrësit.

Përfitues të tryezës ishin 12 gjyqtarë ( 2 nga Gjykata e Apelit ndërkaq 10 gjyqtarë tjerë nga niveli themelor i gjykatave), 11 prokurorë ( 1 nga Prokuroria e Apelit, 1 nga Prokuroria Speciale si dhe 9 të tjerë nga niveli themelor i prokurorive), 3 avokat dhe 1 zyrtarë i lartë për bashkëpunim profesional nga Prokuroria Themelore në Prizren.



## Trajnim: Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit – likuidimi të ndërmarrjeve shoqërore nga AKP

Më 19 Maj 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Roli i Agjencisë dhe procesi i privatizimit – likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore nga AKP”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zhvillimi i shkathtësive të gjyqtarëve për procedurën gjyqësore të rasteve të privatizimit dhe likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore për zgjidhjen e drejtë dhe meritore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë këtij trajnimi është diskutuar për autorizimet ligjore të AKP-së në procesin e privatizimit dhe të likuidimit të NSH-vë, pastaj për likuidimin si proces administrativ, trajtimin e kërkesave kreditore pranë Autoritetit të Likuidimit të NSH-ve, ku më pastaj është paraqitur një vështrim për aprovimin dhe refuzimin e kërkesave pranë AKP-së, si dhe procedurat e më tejme të shqyrtimit të

kërkesave pranë DHPGJS-së.

Më tutje është përfshinë në diskutim edhe procedura administrative pranë Autoritetit të Likuidimit të AKP-së dhe procedurën gjyqësore pranë DHPGJS-së, të cilën kreditori i supozuar ndaj NSH-së është i obliguar ti ndjek në bazë të ligjit të AKP-së dhe Shtojcës së tij dhe LDHP-së, për të realizuar kërkesën e paraqitur ndaj NSH-së në likuidim.

Fokusi i trajnimit ishte në procesin e privatizimit dhe likuidimit vullnetar të NSH-ve, gjegjësisht të aseteve të atyre NSH-ve,

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar dhe raste praktike. Përfitues të këtij trajnimi ishin Gjyqtarët nga Dhoma e Posaçme, gjyqtarët e Gjykatave themelor-divizionit civil.



## Trajnim për Institucionet Ligjzbatuese lidhur me veprat penale kundër Kafshëve

---

Më 19 maj 2022, , në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, në bashkëpunim me Fondacionin për të Drejtat e Kafshëve dhe e mbështetur edhe nga Fondacioni zviceran StrayCoCo, është realizuar trajnimi me temë: “Trajnim për Institucionet Ligj zbatuese lidhur me veprat penale kundër Kafshëve”.

Qëllimi i trajnimit ishte që Gjyqtarët, Prokurorët dhe Hetuesit Policorë, të njoftohen më shumë rreth formave të keqtrajtimit të kafshëve, krahasimet mes procedurave të ndjekjes penale në Zvicër në raport me Kosovë, pastaj mënyrat e mbledhjes së provave në rastet e keqtrajtimit të kafshëve etj.

Trajnimi si fillim u fokusua në një përmbledhje të shkurtët të llojeve të keqtrajtimit të kafshëve dhe si prokuroria zvicerane i trajton këto raste. Pjesëmarrësit patën mundësinë e shtjellimit të dy-tre rasteve tipike zvicerane të abuzimit me kafshë dhe mënyrën se si autoritetet zvicerane

i kanë trajtuar rastet përkatëse.

Në pjesën e pasdites trajnimi u përqendrua në prezantimin e procedurave të ndjekjes penale nga policia dhe prokuroria në Zvicërr dhe krahasimi i procedurave penale në Kosovë.

Me rastin e këtij trajnimi u fol edhe për mbledhjen e provave dhe aspekte tjera të rëndësishme nga perspektiva zvicerane dhe kosovare për të cilat pjesëmarrësit patën mundësinë e shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira në këtë fushë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 6 gjyqtarë dhe 9 prokurorë kryesisht të nivelit themelor si dhe 2 zyrtarë policor dhe një mjekë veterinerë.



## **Punëtori: Shkathësisë e përfaqësimit në gjykim**

---

Me 23-24 maj 2022, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane efektive e cila u elaborua nga në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar punëtorja me temë “Shkathësisë e Përfaqësimit në Gjykim”. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte i avancimi i njohurive të prokurorëve lidhur me teknikat e përfaqësimit në gjykim dhe zbatimi i drejtë në praktikë në rastet gjyqësore.

Në ditën e parë u trajtuan aspekte të rëndësishme të gjykimit, përkatësisht teoria e gjykimit si dhe dhënia e një fjale hyrëse efektive. Në vijim janë trajtuar marrja në pyetje e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë, përdorimi i provave në gjykim dhe dhënia e fjalës përfundimtare si dhe argumentimi për një dënim me vend.

Në ditën e dytë të punëtorisë, pjesëmarrësit patën rastin e studimit dhe analizimit të rasteve praktike dhe përgatitjes së temave dhe strategjisë për gjykim. Secili nga pjesëmarrësit

kishte të japë një fjalë hyrëse për rastin konkret, të demonstrojë marrjen në pyetje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë si dhe të japë fjalën përfundimtare dhe të argumentojë për një dënim me vend.

Në këtë punëtori nga ekspertët ndërkombëtarë u adresuan gjitha çështjet e ngritura rreth gjykimit dhe përfaqësimit në gjykim përmes shpjegimeve dhe zbërthimit të legjislacionit në fuqi sa i përket çështjeve përkatëse.

Përfitues në këtë punëtori ishin 17 prokurorë kryesisht të nivelit themelor nga të gjitha regionet e Kosovës, përkatësisht prokuroret e gjeneratës së VIII dhe disa nga prokuroret gjeneratës së VII të cilët e kanë përfunduar trajnimin fillestar në Akademi të Drejtësisë.





## **Trajnim: Marrja e deklaratës së fëmijëve viktimë nga ekspert- Sesioni II**

---

Më 25-26 Maj 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Marrja e deklaratës së fëmijëve viktimë nga eksperti - Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe akterëve tjerë relevantë lidhur me intervistimin forenzik të fëmijëve për zbatimin e drejtë të procedurës dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve viktimë të dhunës ose të veprave penale.

Trajnimi për dy ditë me radhë trajtojë Kodin e Drejtësisë për të mitur me fokus te koordinimi Prokurori, Polici dhe organe tjera relevante duke ofruar praktikën më të mira të intervistimit forenzik të fëmijëve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar rëndësisë së intervistimit

forenzik duke pas në konsideratë parimet themelore dhe teknikat e bisedës me fëmijën viktimë e krimit për të shmangur riviktimizimin e fëmijës dhe për të siguruar mirëqenien e tij.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore .

Përfitues të këtij trajnimi janë 12 gjyqtarë dhe 7 prokurorë dhe 1 bashkëpunëtorë profesional të cilët kryesisht vinin nga ardhët e nivelit themelor, nga departamenti për të mitur dhe departamenti i përgjithshëm.



## Trajnim: E drejta në pronë-Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr.1 i KEDNJ-së

Më 31 Maj 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “E drejta në Pronë - Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me të drejtën e respektimit të pasurisë së personit dhe mundësinë e privimit nga kjo e drejtë për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuar nga ligji si dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Gjatë trajnimit u trajtuan temat si: Përkufizimi i të drejtës së pronës sipas KEDNJ dhe jurisprudencës së GJEDNJ; Shtirja e të drejtës së pronës sipas KEDNJ dhe jurisprudencës së GJEDNJ; Rregullat e veçanta (tri rregullat) të të drejtës së pronës sipas KEDNJ dhe jurisprudencës së GJEDNJ; Kufizimi i të drejtës së pronës sipas KEDNJ dhe jurisprudencës së GJEDNJ; Zbatimi i së drejtës së pronës ndërmjet palëve private sipas KEDNJ dhe jurisprudencës së GJEDNJ; Nocionet themelore që përmban neni 1. I Protokollit nr.1 i KEDNJ; Pagesat për qasje në dokumente zyrtare, Roli i së drejtës për respektimin e pasurisë së individit; Kushtet për ndërhyrjen e

të drejtës së pronës për arsye të interesit publik; Standardet dhe kriteret për kompensim për privimet nga prona në kontekst të neni 1. Protokollit nr.1 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ.

Në trajnim u theksua se e drejta në pronë është e drejtë e garantuar me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nen ky që ua garanton personave të drejtën për gëzimin paqësor të pasurisë së tyre. Në vijim u tha që nga përmbajta e tekstit, por sidomos nga praktika gjyqësore, ky nen nuk e garanton të drejtën për të fituar pasurinë të drejtën për të blerë apo për të marrë pasuri por vetëm e mbrojnë atë që tashmë është fituar.

Pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të disa rasteve nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe përmes këtyre edhe zërthimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 1. I Protokollit 1., si dhe mënyra e interpretimit që bënë Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg.

Gjatë këtij trajnimi janë përdorur metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë 35 gjyqtarë, prej tyre 1 nga Gjykata Supreme, 5 nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës si dhe 29 gjyqtarë tjerë nga Gjykatat Themelore nga gjitha regjionet e Kosovës.

## Aktivitetet për stafin administrative gjyqësor dhe prokurorial

### Trajnim për Bashkëpunëtorët profesional për rastet e Dhunës në Familje

---

Me 05 Maj 2022, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi për bashkëpunëtor profesional të gjykatave dhe prokurorive me temë: "Dhuna në familje".

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të stafit administrativ, përkatësisht bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive në identifikimin e elementeve esenciale të kësaj vepre dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me dhunën në familje në rastet përkatëse.

Me rastin e këtij trajnimi është trajtuar koncepti i dhunës në familje sipas Kodit Penal të Kosovës, dhuna në familje në aspektin e dhunës psikologjik dhe dhuna ekonomike. Gjithashtu u ofrua edhe perspektiva, përkatësisht praktika e SHBA-së në trajtimin e rateve të dhunës në familje.

Trajnimi kryesisht u zhvillua në formë të bashkëbisedimit mes pjesëmarrësve dhe trajnuesve lidhur me përvojat, dilemat dhe çështjet procedurale gjithmonë bazuar në rastet nga praktika.

Pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve praktike të analizojnë dhe të interpretojnë dispozitat ligjore duke qartësuar edhe më tej elementet e përgjithshme dhe ato te veçanta që përbejnë figurën e veprës penale të dhunës në familje nga neni 248 të KPRK-se dhe të eliminojnë të gjitha dilemat sa i përket formave të manifestimit, procedurës gjyqësore si dhe ndëshkimit të kryesve të kësaj vepre.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 4 staf administrativ nga gjykatat dhe 8 nga prokuroritë që vinin nga radhët e bashkëpunëtorëve profesional, zyrtarëve ligjor dhe referentëve të lartë si dhe 1 mbrojtës i viktimave.

## Trajnim: Moduli bazik për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor

### Pjesa e përgjithshme dhe e posaçme e së drejtës penale

Më 10-13 maj 2022, në bashkëpunim me UNDP, është vazhduar me realizimin e 3 trajnimeve për pjesën e përgjithshme dhe të posaçme të së drejtës penale nga Moduli Bazik për bashkëpunëtor profesional dhe zyrtar ligjor për Grupin e I-të.

Më 25-27 maj 2022, 3 sesionet e njëjta janë realizuar për Grupin e II-të.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive lidhur me kornizën ligjore në fushën penale dhe zbatimi i drejtë në praktikën gjyqësore për zgjidhjen meritore të rasteve.

Në sesionin e parë për dy grupet janë trajtuar parimet e përgjithshme sa i përket zbatimit të ligjit më të favorshëm, vlerësimet lidhur me zbatimin e ligjit më të favorshëm, veprat penale, elementet e veprës penale, mënyra e kryerjes, koha dhe vendi i kryerjes. Në vazhdim janë trajtuar shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë si mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, dhuna dhe kanosja, vepra e rëndësisë së vogël si dhe përgjegjësia penale. Të gjitha këto u ilustruan me raste praktike për të adresuar çështjet që janë sfiduese në rastet përkatëse.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe veprave penale kundër jetës dhe trupit, vrasjes dhe vrasjes së rëndë, veprave penale kundër integritetit seksual si: dhunimi dhe sulmi seksual. Edhe për veprat përkatëse u elaboruan

raste të ndryshme nga praktika gjyqësore të cilat mundësuan diskutimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore për zgjidhjet më meritore të rasteve përkatëse.

**Grupi i I-rë në sesionin e parë kanë marrë pjesë gjithsejtë 35 pjesëmarrës.** Prej tyre 15 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat si dhe 20 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë të lartë për bashkëpunim profesional si dhe praktikantë nga prokuroritë nga të gjitha regjionet e Kosovës

**Grupi i II-në sesionin e parë kanë marrë pjesë gjithsejtë 49 pjesëmarrës.** Prej tyre 24 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat si dhe 25 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë të lartë për bashkëpunim profesional si dhe praktikantë nga prokuroritë nga të gjitha regjionet e Kosovës

Në sesionin e dytë për dy grupet është vazhduar në trajtimin e aspekteve praktike të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale, shqiptimit të dënimit për bashkim të veprave penale, pastaj aspekte praktike të veprave penale kundër pasurisë, veprave penale të narkotikëve, kundër sigurisë së trafikut publik dhe veprat penale të armëve.

Pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit interaktiv me trajnuesit dhe përmes rasteve praktike të eliminojnë paqartësitë dhe çështjet sfiduese me rastin e vendosjes së rasteve përkatëse.

**Grupi i I- rë në sesionin e dytë** kanë marrë pjesë 37 pjesëmarrës. Prej tyre 15 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykatat si dhe 22 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë të lartë për bashkëpunim profesional si dhe zyrtarë tjerë ligjor nga prokuroritë nga të gjitha regjionet e Kosovës

**Grupi i II-të në sesionin e dytë kanë marrë pjesë 50 pjesëmarrës.** Prej tyre 25 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor, sekretare juridike dhe referentë nga gjykatat si dhe 25 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë të lartë për bashkëpunim profesional si dhe zyrtarë tjerë ligjor nga prokuroritë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

**Në kuadër të sesionit të tretë për dy grupet** është vazhduar me shpjegimet rreth kuptimit të personit zyrtar, keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtarë, konfliktit të interesit, përvetësimit dhe mashtrimit në detyrë, marrjes së ryshfetit dhe dhënies së ryshfetit, nxjerrjes së kundërligjshme të vendimeve gjyqësore dhe zbulimit të fshehtësisë zyrtare.

Në pjesën e pasdites është vazhduar me aspekte të rëndësishme nga politika ndëshkimore për veprat penale të korrupsionit duke i njoftuar me Udhëzuesin që është krijuar në zbatim të politikës ndëshkimore. Në vijim janë trajtuar

edhe rrethanat rënduese dhe rrethanat lehtësuese për matjen e dënimit, ndalimi i dyfishimit të rrethanave për matjen e dënimit si dhe faktorët specifik të rrethanave me rastin e matjes së dënimit.

Edhe në këtë sesion pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve praktike për secilën çështje që ishte objekt i trajtimit ti evitojnë dilemat ose edhe pasaktësitë në trajtimin e rasteve të tilla.

**Grupi i I-rë në sesionin e tretë kanë marrë pjesë 36 pjesëmarrës.** Prej tyre 15 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor, shef i zyrës për menaxhim të lëndëve nga gjykata dhe 21 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë të lartë për bashkëpunim profesional si dhe zyrtarë tjerë ligjor nga prokuroritë nga të gjitha regjionet e Kosovës.

**Grupi i II-të në sesionin e tretë kanë marrë pjesë 48 pjesëmarrës.** Prej tyre 23 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë ligjor si dhe sekretare juridike nga gjykata dhe 25 bashkëpunëtorë profesional, zyrtarë të lartë për bashkëpunim profesional si dhe zyrtarë tjerë ligjor nga prokuroritë nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Trajnimi për protokol

Më 12-13 maj 2022, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme për stafin administrativ të gjykatave është realizuar trajnimin me temë: “Protokolli”.

Qëllimi i Trajnimit ishte që stafi administrativ i Gjykatave dhe Prokurorive, përkatësisht zyrtarët e protokollit apo zyrtarët për komunikim me publikun, të fitojnë njohuri bazike dhe të avansuara rreth çështjeve protokolare dhe të zbatojnë drejtë në praktikë gjatë procesit të punës.

Për dy ditë me radhë u trajtuan aspekte të rëndësishme të rregullave protokolare duke filluar nga historiku i protokollit, ngjarjet ndërkombëtare dhe diplomatike, protokollit dhe etika, protokollit me rastin e pritjes së delegacioneve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe protokollit të veshjeve zyrtare,

informatave rreth pritjes së delegacioneve, ceremonialit diplomatik, letrave kredenciale, ftesat, llojet e shkrimit në shkresa etj.

I gjithë trajnimi është realizuar me interaktivitet mes trajnuesit që ishte njëherësh shef i protokollit të shtetit dhe pjesëmarrësve.

Përfitues të trajnimit ishin 19 staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive, prej tyre 7 nga gjykatat dhe 12 nga prokuroritë. Pjesëmarrësit ishin nga radhët e zyrtarëve për informim, zëdhënës, zyrtarë ligjor, administrator dhe pjestarë tjerë nga stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive.



## Aktivitetet për profesionistët tjerë ligjor

### Trajnimi: Praktika gjyqësore në kontestet e punës

---

Më 05 maj 2022, në bashkëpunim me GIZ në kuadër të trajnimeve për profesionistët e tjerë ligjor është realizuar trajnimi dedikuar zyrtarëve të ndihmës juridike falas me temë: “Praktika gjyqësore në kontestet e punës”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që zyrtarët e ndihmës juridike falas të avancojnë njohuritë dhe rrisin kapacitetet e tyre për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive kërkesave të qytetarëve në rastet e kontesteve të punës dhe të përmirësojnë shërbimet e tyre në përputhje me Ligjin për ndihmën juridike falas dhe Ligjin e punës.

Trajnimi është fokusuar në trajtimin teorik dhe praktik të Ligjit të punës duke i kushtuar vëmendje të veçantë bazës ligjore sa i përket kontratave, llojeve të tyre, shkaqeve të shkëputjes së marrëdhënieve të punës si dhe

procedurat para ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit. Po ashtu gjatë këtij trajnimi është diskutuar edhe lidhur me mbrojtjen e të drejtave për të punësuarit brenda organeve të punëdhënësit dhe mbrojtjen e të punësuarit në gjykatë dhe vendimet e gjykatës në rastet kur konstatohet paligjshmëria e ndërprerjes së kontratës së punës.

Me rastin e këtij trajnimi pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit interaktiv me trajnuesit dhe shkëmbimin e përvojave dhe njëkohësisht në adresimin e problemeve praktike që atyre i’u shfaqen gjatë trajtimit të rasteve nga kontestet e punës në praktikë.

Përfitues në këtë trajnim ishin 17 zyrtarë të Agjencisë për ndihmë juridike falas.

### Trajnimi: Barazia gjinore në çështje pronësore të pronësisë së përbashkët

---

Më 06 maj 2022, në bashkëpunim me GIZ në kuadër të trajnimeve për zyrtarët e ndihmës juridike falas, është realizuar trajnimi me temë “Barazia gjinore në çështjet pronësore të pronësisë së përbashkët”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive në çështjet pronësore me qëllim të përmirësimit të shërbimeve të zyrtarëve të ndihmës juridike falas në raport me kërkesat e qytetarëve në realizim të drejtave pronësore dhe zbatimit të drejtë të legjislacionit në fuqi sa i përket barazisë gjinore në rastet pronësore.

Me rastin e këtij trajnimi është trajtuar koncepti i bashkëpronësisë dhe pronësisë së përbashkët, të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve, e drejta e pjesëtimit dhe shuarja e bashkëpronësisë, pronësia e përbashkët,

pronësia e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimit, pasuria e veçantë e bashkëshortëve. Në vijim trajnimi është fokusuar në shpjegimet lidhur me detyrimet e bashkëshortëve mbi bashkësinë martesore, administrimin e pasurisë së përbashkët si dhe në pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve praktike të zbërthejnë dispozitat ligjore që rregullojnë këtë fushë dhe të marrin praktikat më të mira gjyqësore në raste e ndarjes së pasurisë së përbashkët.

Përfitues në këtë trajnim ishin 20 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjionet.

## Trajnimi për Mbrojtësit e viktimave në rastet e Dhunës në Familje

---

Më 31 maj 2022, në bashkëpunim me GIZ në kuadër të trajnimeve për profesionistët e tjerë ligjor është realizuar trajnimi dedikuar mbrojtësve të viktimave me temë: “Dhuna në familje”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që mbrojtësit e viktimave të avancojnë njohuritë dhe rrisin kapacitetet e tyre për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive rasteve të dhunës në familje dhe të përmirësojnë shërbimet e tyre të mbrojtjes në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Trajnimi u fokusua në shpjegimet sa i përket dhunës në familje dhe formave të manifestimit të saj, motivet dhe faktorët që ndikojnë në paraqitjen e dhunës në familje. Në vijim trajnimi u përqëndrua në trajtimin e procedurës në rastet e dhunës në familje me fokus te shyrtimi i Kërkesës për Urdhër mbrojtje, Urdhri

për mbrojtje, Masat mbrojtëse, Mrojtja e fëmijëve në rastet e lëshimit të Urdhër mbrojtjes dhe Urdhër mbrojtjes emergjente si dhe te Ankesa dhe efektet e saj në procedurën e dhunës në familje.

Me rastin e këtij trajnimi pjesëmarrësit patën mundësinë e diskutimit interaktiv me trajnuesit dhe shkëmbimin e përvojave dhe njëkohësisht në adresimin e problemeve praktike që atyre i’u shfaqen gjatë punës së tyre në praktikë.

Përfitues në këtë trajnim ishin 11 mbrojtës të viktimave nga Zyra për Mbrojtje dhe ndihmë viktimave.





## Aktivitetet për trajnues

### Trajnimi i trajnuesve për ndërmjetësimin

Më 21 maj 2022, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Shërbimin Federal të Ndërmjetësimit dhe Pajtitimit (FMCS) të SHBA-së, të mbështetur dhe të financuar nga



Zyra për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL) pranë Ambasadës së SHBA-së, është realizuar sesi i I-rë i Trajnimit të Trajnuesve në fushën e Ndërmjetësimit.

Ky trajnim vije si rezultat i një procesi të gjatë rekrutues, i filluar që nga viti 2021, i cili është përmbyllur gjatë muajit mars 2022, me ç'rast janë përzgjedhur 15 ndërmjetësues për të

vazhduar Trajnimin e Trajnuesve.



Për tri ditë me radhë ndërmjetësuesit patën mundësinë të zhvillojnë kapacitetet e tyre si trajnues së bashku me ekipin e FMCS nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të udhëhequr nga z. Peter Swanson, znj. Emily Rife dhe z. David Moora.

I tërë trajnimi ka qenë i fokusuar në raste praktike dhe simulime, të zhvilluara paraprakisht nga ekipi trajnues, duke filluar me rolin e Ndërmjetësuesit, adresimit të emocioneve tek palët, gjuha e ndërmjetësuesit, arti i marrjes në pyetje dhe teknikat e ndërmjetësimit për të zbërthyer rastet e shumë detaje tjera që luajnë rol të rëndësishëm në procesin e Ndërmjetësimit.




Përfitues të Trajnimit ishin 19 pjesëmarrës të përzgjedhur në grupin e Trajnuesve potencial nga ekipi i FMCS.





## Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve



## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



## Vijueshmëria në trajnime në PTV përmes grafikoneve



# **Akademia e Drejtësisë**

<https://ad.rks-gov.net>

[infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)

Rr. "Muharrem Fejza"-Prishtinë

Tel:+383 38 200 18 660